



Градоначалник на Град Скопје

Kryetari i Qytetit të Shkupit

Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Agjencisë për Punësim të RMV-së (APRMV), dhe Marrëveshjes për bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Qytetin e Shkupit, në suazat e Planit operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2024 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programi - Punë e dobishme komunale i financuar nga Buxheti i Agjencisë për Punësim të RMV-së, më 06.09.2024 shpallet:

THIRRJE PUBLIKE
për
persona të papunë të evidentuar për përfshirje në
Programin për punë të dobishme komunale

Ftohen të papunët e evidentuar të cilët janë të interesuar për t'u përfshirë në programin Punë e dobishme komunale, projekti: "Rritja e gjelbër dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm" ku UNDP është partneri për zbatimin e punësimit me kohë të shkurtuar pune prej 20 (njëzet) orësh në javë, në një periudhë prej 8 (tetë) muajsh me qëllim përvetësimin e shkathtësive dhe përfshirjen graduale në tregun e punës, të regjistrohen në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Qendra për Punësim e Qytetit të Shkupit.

Periudha totale e përfshirjes së personave të papunë përmes programit është 8 muaj, e cila përfshin trajnimin dhe angazhimin në punë.

Të papunët e evidentuar që do të përfshihen në Programin "Punë e dobishme komunale" do të punësohen me kohë të shkurtuar, 20 (njëzet) orë punë në javë, gjatë së cilës statusi i të papunësuarit mbetet i pandryshuar për 8 (tetë) muaj. Kjo do të thotë se ata janë të obliguar të paraqiten rregullisht në APRMV - Qendra për Punësim e Qytetit të Shkupit. Për personat e papunë-përfitues të kompensimit në para dhe përfituesit e së drejtës për asistencë minimale të garantuar gjatë kohëzgjatjes së punësimit e drejta e realizuar paraprakisht do jetë aktive.

Të drejtën për pjesëmarrje në programin "Punë e dobishme komunale" kanë të gjithë personat e papunë, ku përparësi do të kenë personat që aplikojnë për pjesëmarrje në program për herë të parë.



Градоначалник на Град Скопје

Kryetari i Qytetit të Shkupit

Kandidatëve që do të përzgjidhen dhe do të përfshihen në Programin për punë të dobishme komunale do t'u paguhet kompensim monetar në shumë prej 18.000 denarë neto në muaj gjatë kohëzgjatjes së punësimit, tatimi mbi të ardhurat personale dhe sigurimi për aftësi të kufizuar dhe dëmtim fizik të shkaktuar nga lëndimi në punë dhe sëmundje profesionale.

Personat e papunë të evidentuar të cilët do të aplikojnë për pjesëmarrje në Programin për punë të dobishme komunale duhet t'i përkasin njërit prej grupeve të synuara të personave të papunë:

- persona të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj në evidencë, me përparësi për personat e papunë mbi 5 vjet)
- të rinj deri në 29 vjeç
- më të vjetër se 50 vjeç
- persona përfitues të asistencës minimale të garantuar
- persona përfitues të kompensimit monetar në bazë të papunësisë
- persona që kishin statusin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore
- viktimat të dhunës në familje
- personat me aftësi të kufizuara
- gra pjesëtare të komunitetit etnik rom dhe komuniteteve të tjera etnike
- personat që i përkasin komunitetit etnik rom
- prindër kryefamiljarë

Vendet e punës që përfshihen me këtë njoftim i referohen punësimit të:

Vendi i punës 1: Asistent arsimor/me këto detyra pune:

- Angazhimi ditor 4-orësh në shkollë;
- ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në mësimdhënien e rregullt përmes llojeve të ndryshme të qasjes individuale, të diferencuar dhe metodologjike në punë;
- ndihmë dhe mbështetje e prindërve përmes bashkëpunimit me ta;
- bashkëpunimi me komunitetin;



Градоначалник на Град Скопје

Kryetari i Qytetit të Shkupit

- bashkëpunimi me bashkëpunëtorë profesionistë dhe ekip gjithëpërfshirës i studentit;

Kualifikime të domosdoshme për vendin e punës 1:20 asistentë

Arsimi i lartë i përfunduar për: edukator dhe rehabilitues special, pedagog, psikolog, punonjës social, pedagog social dhe rehabilitues, me nivel të përfunduar VII/1, përkatësisht VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve MRK ose 240 EKTS, si dhe person që i plotëson kushtet për mësimdhënës në klasë fillore (shkalla VII/1, përkatësisht VI A sipas MRK ose 240 EKTS), si dhe mësues në mësimdhënie lëndore (shkalla VII/1, përkatësisht VI A sipas MRK ose 240 EKTS),

Vendi i punës 2: asistent personal për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt me detyrat e mëposhtme:

- Katër orë angazhim në ditë;
- ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për nxënësit dhe shoqërimi i tyre gjatë procesit mësimor dhe lehtësimi i kapërcimit të pengesave fizike gjatë mësimi;
- ndihmë dhe mbështetje e prindërve përmes bashkëpunimit me ta;
- bashkëpunimi me komunitetin;
- bashkëpunimi me bashkëpunëtorë profesionistë dhe ekip gjithëpërfshirës i studentit;

Kualifikimet e domosdoshme dhe karakteristikat personale për vendin e punës 2:

Gjithsej 15 asistentë

- Ndjeshmëri, aftësi komunikuese, fleksibilitet, tolerancë ndaj mundësive të ndryshme, durim, stabilitet i lartë emocional, përgjegjësi, disponueshmëri, llogaridhënie.
Arsimi i nevojshëm: PPL ose PPM.

Të papunët e interesuar do të mund të depozitojnë Aplikimet për pjesëmarrje në programin “Punë e dobishme komunale” në APRMV – Qendra për Punësim e Qytetit të



Градоначалник на Град Скопје

Kryetari i Qytetit të Shkupit

Shkupit në periudhën nga 06.09.2024 deri më 16.09.2024, nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet më specifike do të rregullohen me nënshkrimin e Kontratës ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe kandidatëve të përzgjedhur.

Informata të hollësishme për programin "Punë e dobishme komunale" mund të merren në Qytetin e Shkupit te drejtuesja e Sektorit për Përkujdesje Sociale, Fëmijë dhe Shëndetësore - Dr. Vesna Damçevska Ilievska - Koordinatore komunale për programin "Punë e dobishme komunale" tel: 02/ 3297 278 dhe në Agjencinë për Punësim – Qendra për Punësim e Qytetit të Shkupit.

